



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 514/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje(LVV) dega në Malishevë paraqitur kundër të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)dega në Malishevë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, në të cilën ka pretenduar se me dt 02 Nëntor rreth orës 22.50, pika e karburantit Pajtimi në Malishevë, ka dhënë mbi 9000 euro derivate në këmbim të votës, edhe pse aktivistët e tyre i kanë verifikuar disa raste, kanë siguruar vetëm një faturë të naftës, e cila është e bashkangjitur si dhe me këtë konsiderojnë se ka bërë shkelje të nenit 215 të Kodit Penal të Kosovës .

PZAP-i lidhur me rastin në fjalë e informoi policinë e Kosovës për rastin në fjalë dhe kerkoi që të ndërmiren veprimet konkrete.

Në përgjigjen e saj policia e Kosoves thekson se nuk kemi pasur informata të plota për këtë rast dhe se nuk kanë arritur të vërtetojnë se për cilën qendër të votimit bëhet fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: ``Mund të apelohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar ``.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, si dhe këto pretendime nuk kanë arritur të vërtetohen edhe nga policia, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

Anr. 514/2013 më datën 07.11.2013



**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.